11*	Vida 4.0mm x15mm	Me perberje titaniumi, me kend fiks, cancelous, permasa 4.0 X15mm	cope	500
12	Vida transpedikulare 4.0x30mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 4.0x30mm	cope	40
13	Vida transpedikulare 4.0x40mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 4.0x40mm	cope	40
14	Vida transpedikulare 4.5x40mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 4.5x40mm	cope	80

15	Vida transpedikulare 4.5x45mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 4.5x45mm	cope	40
16	Vida transpedikulare 5.5x40mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 5.5x40mm	cope	100
17*	Vida transpedikulare, 5.5x45mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale, me profil te ulet permasa 5.5x45mm	cope	500
18	Vida transpedikulare, 6.5x40mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale profilt te ulet, permasa 6.5x40mm	cope	40
19	Vida transpedikulare, 6.5x45mm	E perbere prej titaniumi, multiaksiale profilt te ulet, permasa 6.5x45mm	cope	800
20*	Koke filetuese me sistem break-off	E perbere prej titaniumi dhe me sistem thyerje break off	cope	1700
21*	Shufer titani 5.5mmx500mm	Shufer titani me permasa 5.5 X 500mm	cope	200
22	Cage per perdorim intervertebral lumbar	22 mm x , 10,12, 14 mm	cope	20
23	Cage per perdorim intervertebral lumbar	26 mm x , 10,12, 14 mm	cope	20
24	Cage per perdorim intervertebral lumbar	36 mm x , 10,12, 14 mm	cope	20
25*	cervical posterior fixation Rod 3.2mm x 240mm	E perbere prej titaniumi, permasat 3.2mm x 240mm	cope	10
26	Vide multiaksiale 3.5 X14mm	Me perberje titaniumi, multiaksiale 3.5mm x 14mm	cope	30
27	Vide multiaksiale 3.5 X16mm	E perberje titaniumi, multiaksiale 3.5mm x 16mm	cope	20
28	Vide multiaksiale 3.5 X22mm	E perberje titaniumi, multiaksiale 3.5mm x22mm	cope	20
29	Vide multiaksiale 3.5 X24mm	E perberje titaniumi, multiaksiale 3.5mm x 24mm	cope	20
30	Vide multiaksiale 4.0 X26mm	4.0mm x 26mm Multi Axial Screw	cope	40
31*	Vide multiaksiale 4.0 X28mm	4.0mm x 28mm Multi Axial Screw	cope	40
32	Vide multiaksiale 4.0 X30mm	4.0mm x 30mm Multi Axial Screw	cope	40
33	Vide multiaksiale 4.0 X34mm	4.0mm x 34mm Multi Axial Screw	cope	40
34	Vide multiaksiale 4.0 X38mm	4.0mm x 38mm Multi Axial Screw	cope	40

35	Vide kocke multiaksiale pjeserisht me fileto - Partially Threaded multi-axial bone Screws	4.0mm x 26mm Multi Axial Screw	cope	40
36	Partially Threaded multi-axial bone Screws	4.0mm x 28mm Multi Axial Screw	cope	40
37*	Rod Connector	3.2 to 5.5mm	cope	20
38	Grep Cervikal 4.5mm	posterior	cope	4
39	Grep Cervikal 6mm	posterior	cope	4
40	Vida fikse 4.5 X 40mm	Me perberje titani 4.5x40mm	cope	40
41*	Koka filetuere per sistemin e fiksimit cervical posterior	Te pershtshme per vidat e fiksimit cervical posterior	cope	320
42	Pllake fiksime kraniocervikal me 4 pozicione	Me perberje titaniami, e mesme, gjeresia mes shufrave 36mm	cope	10
43*	Pllake fiksime kraniocervikal me 4 pozicione	Me perberje titaniami, e vogel, gjeresia mes shufrave 24mm	cope	2
44	Vida kortikale per fiksime kraniocervikal	Me perberje titaniami, 4.0x8mm	cope	60
45*	Vida kortikale per fiksime kraniocervikal	Me perberje titaniami, 4.0x6mm	cope	16
46	Pjese paramotori i pershtatshem per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	elektrik me shpejtesi te larte, me forme stylus, me kabell te integruar	cope	2
47	Zgjituesi i motorit i kurbuar i pershtatshem per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	I kurbuar 3.2mm, gjatesi 9cm	cope	2
48	Freze me koke diamond te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 9cm, diametri 3mm	cope	20
49	Freze me koke te vijeuar te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 9cm, diametri 6mm	cope	20
50	Zgjatuesi i motorit i drejte i pershtatshem per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	I drejte 2.4 mm, gjatesi 7 cm	cope	2
51	Freze me koke diamond te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 7cm, diametri 3mm	cope	30
52	Freze me koke te vijeuar te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 7cm, diametri 6mm	cope	30

53*	Freze me koke spirale te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 7cm, diametri 1.5mm	cope	10
54*	Zgjatues i motorrit me mbrojtje per duren i pershtatshem per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	I drejte 2.3 mm	cope	2
55*	Freze gjatesore per kocka te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 7cm, diametri 2.3mm	cope	70
56	Zgjtuesi i motorit i kurbuar i pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	I kurbuar 3.2mm, gjatesi 15cm	cope	2
57	Freze me koke diamond te pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	gjatesia 15cm, diametri 3mm	cope	20
58	Zgjtuesi i motorit per prerjen e metaleve pershtatshme per kraniotomin IPC (Integrated Power Console)	I drejte, gjatesia 9cm	cope	2
59	Freze ne forme disku per prerjen e metaleve	gjatesia 9cm, diametri frezes 25-26mm	cope	10
60*	DYLL (Bone Wax)Kuti me 24 Paketa	DYLL (Bone Wax)Kuti me 24 Paketa	Kuti me 24 paketa	60
61*	Hemostat e absorbueshme 5 x 7.5 cm,	Hemostat e absorbueshme 5 x 7.5 cm,	Kuti me 12 paketa	30
62*	Sfungjer hemostatik prej xhelatine 80X50X10mm	Sfungjer hemostatik prej xhelatine 80X50X10mm	cope	400
63*	Drena Aspirativ per plage kirurgjie	Drena Aspirativ per plage kirurgjie	cope	600
64*	Veshje Sterile Njepedorimshe Mikroskopi	Veshje Sterile Njepedorimshe Mikroskopi	cope	200
65	Sistem drenimi lumbar	Sistem drenimi lumbar	cope	10
66*	Katetere Ventrikular I veshur me barium, diametri I brendshem 1.3mm, gjatesi 23cm	Katetere Ventrikular I veshur me barium, diametri I brendshem 1.3mm, gjatesi 23cm	cope	10
67	Katetere peritenoal I veshur me barium, 90cm	Katetere peritenoal I veshur me barium, 90cm	cope	10

68	Sistem drenimi ventrikular	Sistem drenimi ventrikular	cope	8
69*	Valvul e programueshme per trajtim hidrocefalik	Me 5 nivele te programueshme presioni nga 0.5 deri ne 2.5, profili jo me shume se 7mm, gjeresi jo me shume se 16mm.	cope	20
70*	Sensor per monitorimin e indeksit bispektral	Sensor per monitorimin e indeksit bispektral	cope	50
71	Silk 4-0: 1.5 metric , gjatesia 75 cm dimension age 17mm, 1/2 circle round bodied needle	Silk 4-0: 1.5 metric , gjatesia 75 cm dimension age 17mm, 1/2 circle round bodied needle	cope	200
72*	Polypropylene me polietilen 6-0: 0.7 metric, gjatesia 75 cm, me dy age 12-13mm, 3/8 rrethore, round bodied	Polypropylene 6-0: 0.7 metric, gjatesia 75 cm, me dy age 12-13mm, 3/8 rrethore, round bodied	cope	50
73	Cimento Cranioplastike	Cimento Cranioplastike	cope	20
74	Mbrojtes i Dures Spinale 3ml	Mbrojtes i Dures Spinale 3ml	cope	8
75	Mbrojtes i Dures Kraniale 5ml	Per aplikime kraniale, me perberje PEG ester (Polyethylene Glycol) and Trilysine amine	cope	8
76	Graft per riparimin e dures kraniale dhe spinale, 5x5cm	Graft per riparimin e dures spinale, 5x5cm	cope	10
77	Graft i absorbueshem per riparimin e dures kraniale dhe spinale 5 in x 7 in (12.5 cm x 17.5 cm)	Me perberje kolagjeni per riparimin e dures kraniale dhe spinale 5 in x 7 in (12.5 cm x 17.5 cm)	cope	10
78*	Material i pa absorbueshem per zevendesimin e Dures	Material sintetik i pa absorbueshem i perbere prej pelhure mikroporoze poliesteruretan, permasa 12 x 14 cm	cope	10
79	Pllake Kraniale e drejte me dy vrima. (Cranial Plate, straight with two holes).	Pllake kraniale e drejte, titaium, me 2 vrima, permasa e boshtit 8mm, e ngushte, profili 0.5-0.6mm	cope	20
80	Pllake Kraniale e drejte me kater vrima. (Cranial Plate, straight with four holes).	Pllake kraniale e drejte, titanium, me 4 vrima, profili 0.5-0.6mm	cope	10
81	Pllake Kraniale e drejte me njetzet vrima. (Cranial Plate, straight with twenty holes).	Pllake kraniale e drejte, titaium, me 20 vrima, profili 0.5-0.6mm	cope	2
82	Vida Kraniale. (Cranial Screw)	Vida kraniale titaniumi diameter 1,5-1.6mm x 5-7mm.	cope	50
83	Vida Kraniale. (Cranial Screw)	Vida kraniale titaniumi diameter 1,5-1.6mm x 9-11.0mm.	cope	50

84	Sfera per neuronavigator	Sterile	cope	50
85*	Set per matjen e presionit Intrakranial: kabell zgjatues ICP, nderfaqe ICP, kabell per monitor pacienti	Set per matjen e presionit Intrakranial: kabell zgjatues ICP, nderfaqe ICP, kabell per monitor pacienti	set	8
86	Set transducer per matjen e presionit intrakranial me kit buloni metalik/kit ventrikular	Set transducer per matjen e presionit intrakranial me kit buloni metalik/kit ventrikular	cope	50
87	Qafore cervikale	Qafore cervikale	cope	100
88	Graft ndervertebror	I perbere prej materiali polyetheretherketone, me permasa 15mmx12mmx5mm / 5mmx12mmx6mm / 15mmx12mmx7mm / 15mmx12mmx8mm me mekanizem bllokimi te integruar.	cope	50
89*	Vida per graft ndervertebror	Material titanium, diameter 3.5mm dhe 4mm, gjatesi 11mm, 13mm dhe 15mm me vete-filetim.	cope	100
90*	Mbulese C-Arm	Veshje sterile per C-Arm	cope	800
91	Pince Bipolari	Ne forme bayonet	cope	20
92	Elektrode me hidroxhel	Me strip ngjites akriliku, e ndare ne dy sektore, sistem monitorimi te kontaktit.	cope	200
93*	Klipe Ligature Titanium	Mesatare, ambalazhim 30 fisheke me nga 6 klipe	kuti me 30 fisheke me nga 6 klipe	16
94*	Shirit steril kirurgjikal 12-13mm x 75-77mm	Për mbrojtjen e indeve te trurit dhe indeve te tjera të sistemit qendror nervor gjate kirurgjive intrakraniale, I detektueshem nga rrezet X	Kuti me 10 cope	100
95	Shirit steril kirurgjikal 12-13mm x 50-52mm	Për mbrojtjen e indeve te trurit dhe indeve te tjera të sistemit qendror nervor gjate kirurgjive intrakraniale, I detektueshem nga rrezet X	Kuti me 10 cope	40
96	Shirit steril kirurgjikal 25-26mm x 75-77mm	Për mbrojtjen e indeve te trurit dhe indeve te tjera të sistemit qendror nervor gjate kirurgjive intrakraniale, I detektueshem nga rrezet X	Kuti me 10 cope	200

97	Klipe skalpi	Klipe per fiksimin e skalpit, sterile, plastike	Kuti (20 fisheke me 10 klipe)	10
98	Klipe kutan metalike	me shume perdorime dhe me fiksim automatik	kuti me nga 10 cope	10
99	Kit Drejtues Trajektore Per biopsi cerebrale, i jashtem	Te jete I perputhshem me sistemin e neuronavigimit S7 ose ekuivalent, sterile	cope	4
100	Kit drejtues trajektore per biopsi cerebrale, i brendshem	Te jete I perputhshem me sistemin e neuronavigimit S7 ose ekuivalent, sterile	cope	4
101	Set biopsie pasive	Te jete I perputhshem me sistemin e neuronavigimit S7 ose ekuivalent, shume perdorimeshe	cope	2
102	Kit age biopsie pasive	Te jete I perputhshem me sistemin e neuronavigimit S7 ose ekuivalent, sterile	cope	6
103	Bone Marrow Biopsy Set	Age per marrjen e Biopsive kockore 11 G x 100 mm, 13 G x 10 cm	cope	50
104	Single needle electrode	gjatesia 13-14mm, diametri 0.4-0.45mm	cope	60
105*	Single needle electrode	gjatesia 17-18mm, diametri 0.4-0.45mm	cope	60
106	Dual (twisted pair) needle electrode	gjatesia 13-14mm, diametri 0.4-0.45mm	cope	50
107*	Dual (twisted pair) needle electrode	gjatesia 17-18mm, diametri 0.4-0.45mm	cope	50
108	Corkscrew electrode	gjatesia e kabllit 150-250cm	cope	50
109	Set elektrodash siperfaqesore EMG,	pre-gelled, permasa jo me e vogel se 20x22cm set me 3 cope kuqe, zeze, jeshile	cope	120
110	Sonde monopolare	me konektor touch prof.	cope	6
111	Sonde bipolare	me konektor touch prof.	cope	6
112	Cimento Kifoplastie	Cimento kockore e pershtatshme per procedura kifoplastie dhe vertebroplastie	cope	6
113	Kit Kifoplastie	Set i perbere nga: 2 vegla per aksesimin e kockes; 1 tamp per fryrjen e kockes; 6 pasjisje per mbushjen e kockes; 2 cope shiringa fryrje, 2 cope age aksesi kocke 11g	cope	6

114	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 7.0 Mm Gjatesi, I Drejte	cope	8
115	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 7.0 Mm Gjatesi, I Kurbuar	cope	4
116	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perkohshëm, 7.0 Mm Gjatesi	cope	2
117	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent Standart, I Perhershëm, 7.8 Mm Gjatesi	cope	4
118	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent Standart I Perkohshëm 9.0 Mm Gjatesi	cope	4
119	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 6.1 Mm Gjatesi	cope	2
120	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 8.0 Mm Gjatesi	cope	2
121	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 8.3 Mm Gjatesi	cope	8
122	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 10.2 Mm Gjatesi	cope	4
123	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart I Fenestruar, I Perhershëm, 3/8.1 Gjatesi	cope	2
124	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart I Fenestruar, I Perhershëm, 4/9.1 Gjatesi	cope	4
125	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart I Fenestruar, I Perhershëm, 5/7.8 Gjatesi	cope	4
126	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, Mini, 4.0 Gjatesi	cope	2
127	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, Mini, 5.0 Gjatesi	cope	2
128	Klip Aneurizmi	YASARGIL Aliazh Titani Ose Ekuivalent, Standart, I Perhershëm, 17.5 Mm Gjatesi, I Drejte	cope	2
129	Aplikator Per Klipe Aneurizmi	Aplikator Per Klipe Aneurizmi	cope	2
130	Kabull Bipolari		cope	20

131*	Veshje sterile per Oarm	ne forme tubolare	cope	400
132*	Trokar	per neuroendoskop	cope	2
133	Doreze per trokar	per neuroendoskop	cope	2
134	Tuba Irrigimi	per neuroendoskop	cope	10
135	veshje sterile endoskopi	per kamera neuroendoskopit	cope	26
136	solucion antifog	per endoskop	cope	50
137*	retraktor per traksion cervikal	me 2 pine te rregullueshme	cope	2
138	vida spinale 4.5mm per sistem perkutan	diametri 4.5mm gjatesi 30mm;35mm;40mm, te kanjuluara	cope	10
139	vida spinale 5.5mm per sistem perkutan	diametri 5.5mm gjatesi 30mm; 35mm; 40mm; 45mm;50mm, te kanjuluara	cope	30
140	vida spinale 6.5mm per sistem perkutan	diametri 6.5mm gjatesi 35mm; 40mm; 45mm;50mm;55mm, te kanjuluara	cope	40
141	shufer perkutane	diametri 5.5mm, material kobalt Krom me gjatesi 70-260mm	cope	20
142	koke filetuese per sistem perkutan	E perbere prej titaniumi dhe me sistem thyerje break off	cope	80
143	Aspirator kranial Rabbe	gjatesia e punes 100-140mm, diametri 4Fr; 6Fr; 8Fr	cope	2
144	Aspirator	per neuroendoskopi	cope	2
145	Introducer Nje Perdorimsh,	19 fr, i pershtatshem me neuroendoskop aescalap ose ekuivalent	cope	20
146	Vaj per motorrin e kraniotomise	Vaj per motorrin e kraniotomise	cope	2

**Afatet e lëvrim:** Sasia e mallit duhet të lëvrohet sipas nevojave të AK brenda **2 (dy)** muajve duke filluar nga data e nënshkrimit të kontrates.

Afati i skadencës: jo më i vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush specifikimet teknike OE duhet të paraqesë mostra për artikujt me shenjen (\*).

---

## Shtojca 8.

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

##### OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera,

Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën

---

**jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
  3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

*Shënim:* Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e deklaratës. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e certifikatës.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA **ose ekuivalente / të barasvlefshme** me to për artikujt e ofruar, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
5. Operatori duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve objekt prokurimi.
6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë teknikë / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregëtim të pajisjeve mjekësore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas ligjit 89/2014 datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”.

- 
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **ofertën teknike**, për artikujt objekt prokurimi sipas numrit rëndor në Shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve” në formë tabele, ku të pasqyrohet: Emërtimi i artikullit, Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, si dhe certifikimet përkatesë për produktin.
9. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për artikujt me shenjën (\*) në listë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara. Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara SHA në adresën: *Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:
- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit *“Blerje materiale mjekimi specifike për Shërbimin e Neurokirurgjisë në SUT”* dhe jo para datës **22.06.2026, ora 11:00** (\*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).
  - Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
  - Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rëndor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.
  - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.
10. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>6</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

<sup>6</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

## Mbi Konfliktin e Interesit

### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

<b>Deklarata</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</li> </ul> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse, po, numri i punonjësve:  _____  Profili i punonjësve  _____  <u>Makineri e mjete</u>

	Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
<b>Emri, Mbiemri</b> _____ <b>Firma</b> _____ <b>Vula</b> _____ <b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

---

**Shtojca 10.**

